



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr.370/2018
Datë: 7 shtator 2018

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 17 paragrafi 3 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur me datë 7 shtator 2018, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Miratohet pjesërisht raporti i Komisioni për avancim të katër (4) prokurorëve të shtetit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, si në vijim:
 1. Z. Valdet Gashi, avancohet nga Departamenti për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
 2. Z. Naim Abazi, avancohet nga Departamenti i përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
 3. Z. Atdhe Dema, avancohet nga Departamenti i Përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
 4. Z. Enver Krasniqi, avancohet nga Departamenti i përgjithshëm i Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës
- II. Refuzohet propozimi i Komisionit për avancimin e prokurorit të shtetit z. Arian Gashi, nga Departamenti për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prishtinë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
- III. Për prokurorët e cekur në pikën I të këtij vendimi të hartohen vendime të veçanta dhe të jenë pjesë e dosjes personale të tyre.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikoi në faqet zyrtare të KPK-së dhe PSH-së.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Sekretariatit të KPK;
- NJSHP;
- Arkivit të KPK-së.